



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

2021:054819

Numri i lëndës:

Datë: 13.05.2024

Numri i dokumentit: 05673347

**PAKR.nr.121/2024**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi - kryetar, Afërdita Bytyçi dhe Zyhdi Haziri - anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bajram Rexhahmetaj, në çështjen penale kundër të akuzuarve: F.L. për shkak të veprën penale, Vrasja në tentativë nga neni 172, lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, të akuzuarit A.S. për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale Vrasja në tentativë nga neni 172, lidhur me nenin 33 dhe 28 të KPRK-së, të akuzuarit F.T. për shkak të veprës penale, Vrasja në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 21 par.3 të KPRK-së, dhe veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, si dhe të akuzuarit K.Ç. për shkak të veprës penale, Moslajmërimi i përgaditjes se veprave penale nga neni 377 par.1, lidhur me par.2, nënpar. 2.2 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, F.L., av. F. Sh. ankesën e mbrojtësit të akuzuarit A.S. av. L.M. ankesën e mbrojtësit të akuzuarit F.T. av.A.I. të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, 2022:234826, datë 16.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK-së, më datë 12.04.2024, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, si dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve F.L. av. F.Sh. A. S., av. L.M., F. T., av. A.I. ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, 2022:234826, datë 16.01.2024, **VËRTETOHET**.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin, 2022:234826, datë 16.01.2024, të akuzuarin F.L. e ka shpallur fajtor për veprën penale, Vrasja në tentativë nga neni 172 lidhur me 28 të KPRK-së, dhe për veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, të akuzuarin A.S. e ka shpallur fajtor për veprën penale, ndihmë në kryerjen e veprës penale, Vrasja në tentativë nga neni 172, lidhur me nenin 33 dhe 28 të KPRK-së, të akuzuarin F.T. e ka shpallur fajtor për veprën penale, Vrasja në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 21 par.3 të KPRK-së, dhe veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe i ka gjykuar si në vijim:

Të akuzuarin F.L. për veprën penale, Vrasja në tentativë nga neni 172 lidhur me 28 të KPRK-së, më denim me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 22 mars 2021 deri më 06.12.2022, dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 06.12.2022 deri më 05.02.2023. Për veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, më denim me gjobë në lartësi prej 1000 € (njëmijë euro) të cilën gjobë është obligua i akuzuari ta paguajë në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) dite, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguaj dënimin me gjobë, i njëjti në pajtim me nenin 46 par.3 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për njëzetë /20/ euro gjobë të papaguara, i akuzuari do të vuaj nga një /1/ ditë burg.

Të dëmtuarit F.T. dhe L.T. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Në mënyrë të përhershme janë konfiskuar 21 (njëzetë e një) copë fishek të llojit AK 47.

I akuzuari është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 € (njëqind euro), dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit është obliguar të paguaj shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro) në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Të akuzuarit A.S. gjykata i ka shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 4 (katër) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga data 22 mars 2021 deri më 24 maj 2022.

I akuzuari A.S. është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 € (njëqind euro) dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit është obliguar të paguaj shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

I akuzuari F.T. për veprën penale, Vrasja në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 21 par.3 të KPRK-së, dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 31 mars 2021 deri më 06.12.2022, dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 06.12.2022 deri më 05.02.2023. Për veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, dënim me gjobë në lartësi prej 1000 € (njëmijë euro) të cilën gjobë është obliguar ta paguajë në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) dite, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguaj dënimin me gjobë, i njëjti në pajtim me nenin 46 par.3 të KPRK-së do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për njëzetë /20/ euro gjobë të papaguara, i akuzuari do të vuaj nga një /1/ ditë burg.

Të dëmtuarit: F.L. A.S. dhe K.Ç. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

I akuzuari F.T. është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 € (njëqind euro), dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit është obliguar ta paguaj shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro) në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Konform nenit 364 par.1, nënpar.1.3 të KPPK-së, i akuzuari K.Ç. është liruar nga aktakuza për veprën penale, Moslajmërimi i përgaditjes së veprave penale nga neni 377 par.1, lidhur me par.2, nënpar. 2.2 të KPRK-së, pasi që nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar mirë se ka kryer këtë veprë penale për të cilën është akuzuar. Shpenzimet e procedurës kanë rënë mbi barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata Apelit, aktgjykimin e ankimuar t'a anuloj dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, ose aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të akuzuarve F.L., A.S. dhe F.T. t'iu shqiptoj dënime me të larta në proporcion me peshat e veprave penale të kryera, ndersa të akuzuarin K.Ç. t'a shpall fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe ti shqiptoj sanksion penal të paraparë me Kodin Penal të Kosovës.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.L., av. F.Sh. për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar t'a anuloj dhe çështjen t'a kthej në rigjykim dhe rivendosje ose aktgjykimin t'a ndryshoj ashtu që të akuzuarin F.L. t'a liroj nga akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.S. av. L.M. për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar t'a ndryshoj ashtu që të akuzuarin A.S. ta liroj nga akuza, ose ti shqiptoj një dënim të kushtëzuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.T., av. A.I. për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar t'a

ndryshoj ashtu që të akuzuarin F.T. ta liroj nga akuza, për veprën penale nën pikën III a). Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me neni 28 të KPRK-së, sepse vepra e cekur nuk është vepër penale sipas nenit 12 par.1 dhe par.2 të KPRK-së, apo ti zbutë dënimin e shqiptuar me gjobë për veprën penale të prezantuar nën pikën III b) Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, apo aktgjykimin e ankimuar t'a anulon dhe lëndën t'a kthejë në rigjykim.

Prokurori i Apelit më parashtrësën, PPA/I.nr.130/2024, datë 04.03.2024, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, të aprovet si e bazuar, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, 2022:234826, datë 16.01.2024, të ndryshoj, ashtu që të akuzuarve F.L. A.S. dhe F.T. t'iu shqiptohen dënime më të larta me burgim, ndërsa të akuzuarin K.Ç. t'a shpall fajtor dhe t'a dënoj me dënim meritator, ose aktgjykimin e ankimuar t'a anuloj dhe çështjen t'a kthejë në rigjykim dhe rivendosje, ndërsa ankesat e mbrojtësve të akuzuarve F.L. av. F.Sh. A.S. av. L.M. F.T. av. A.I. të refuzohen si të pa bazuara.

Gjykata e Apelit caktoj dhe mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPRK-së, në të cilën morën pjesë: mbrojtësi i të akuzuarit F.L., av. F.Sh., mbrojtësi i të akuzuarit A.S. av. L.M., si dhe mbrojtësi i të akuzuarit F.T., av. A.I. ndërsa nuk prezantuan të akuzuari F.L. A.S. F.T., K.Ç. dhe as Prokurori i Prokurorisë së Apelit edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës së kolegjit, andaj, seanca e kolegjit u mbajt konform nenit 390 par. 4 të KPPRK-së, në mungesë të tyre. Në seancë mbrojtësi i të akuzuarit F.L. av. F.Sh. pasi që elaboroj pretendimet e bëra në ankesë mbeti pranë propozimit të bërë në ankesë. Mbrojtësi i të akuzuarit A.S. av. L.M. pasi sqaroi disa nga pretendimet ankimore ngeli pranë propozimit të bërë në ankesë. Mbrojtësi i të akuzuarit F.T. av. A.I. po ashtu pasi elaboroj disa nga pretendimet ankimore mbeti pranë propozimit të bërë në ankesë.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, ankesat e mbrojtësve të akuzuarve F.L. A.S dhe F.T. propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

**Ankesat nuk janë të bazuara.**

*Pretendimet ankimore të Prokurorisë*

Në ankesë prokurori pretendon se gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të dënimeve të shqiptuar të akuzuarve si në aktgjykimin e ankimuar gabimisht ka çmuar rrethanat lehtësuese sepse në rastin konkret të akuzuarit nuk janë të një moshe relativisht të re, pasi që i akuzuari F. L. është i moshës 30 vjeç, i akuzuari A.S. i moshës 37 vjeç, ndërsa i akuzuari F.T. i moshës 33 vjeç, pastaj sjelljen e të akuzuarit F.T. siç ka potencuar gjykata se i njëjti ka qenë konsistent që nga fillimi i kësaj procedure, nuk duhet kuptuar si pranim fajësie pasi i njëjti në asnjë moment nuk ka pranuar kryerjen e veprës penale ndërsa edhe pse ka pranuar mbajtjen në pronësi dhe kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, i njëjti në asnjë moment nuk ka treguar se ku gjendet arma e përdorur në kryerjen e veprës penale në mënyrë që e njëjta më pas të sekuestrohet, ekzaminohet dhe konfiskohet. Sa i përket rrethanave rënduese, përveç asaj që gjykata i ka përmendur se bazuar në të dhënat nga sistemi SMIL të njëjtit kanë qenë edhe më parë të gjykuar e posaçërisht i akuzuari F.T. gjykata në vend se të njëjtëve t'iu shqiptoj dënimin e merituar, u ka shqiptuar dënim minimal ndërsa nuk ka marrë mundin fare as edhe të përmend rrethanat tjera rënduese: si shkallën e përgjegjësisë së tyre penale, shkallën e lartë të dashjes për kryerjen e veprave penale, motivin e kryerjes së veprave penale, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur-jetës së njeriut, etj.

Gjykata me rastin e vendosjes për lirimin nga akuza të të akuzuarit K.Ç. gabimisht ka konstatuar se nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, aq më tepër kur të pjesa liruese e aktgjykimin për këtë të akuzuar ka konstatuar se 'Pavarësisht faktit se është vërtetuar që K.Ç. së bashku me të akuzuarin A.S. kishin qenë me datë 7 mars 2022 në shtëpinë e të akuzuarit F.L. në fshatin S. ku kishin qëndruar rreth një orë e gjysmë në veturë dhe si rrjedhojë me tu kthyer në drejtim të K., !!! po ashtu ka qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes.... kjo nuk e bën të besueshëm faktin se i akuzuari ka pasur dijeni për përgatitjen e kryerjes së veprës penale të vrasjes. Mbi bazën e këtij përshtkrimi konsideron se gjykata ka rënë në kundërshtim me vetveten pasi që në po këtë aktgjykim disa herë ka potencuar se ngjarjes që është objekt i kësaj çështje penale (7 mars 2022) i kishte paraprirë një ngjarje e një dite më parë e që për gjykatën ka qenë një nga shkaqet kryesore (por jo i vetëm) e që kishte të bënte me një mosmarrëveshje në mes të akuzuarit F.L. vëllait të tij S.L. dhe K.Ç. në njërin anë dhe personit L.T. në anën tjetër për çka siç është potencuar më lartë, nga Prokuroria Themelore në Ferizaj edhe ishte ngritur aktakuzë ndaj S.L. F.L. dhe K.Ç. Pastaj fakti tjetër se është vërtetuar që ditën kritike A.S. së bashku me K.Ç. kanë shkuar për ta vizituar shokun e tyre F.L. në shtëpinë e tij në S. ngase kishin qenë në dijeni se i njëjti një natë më parë ishte përfshi në një rrahje ku edhe ishte lënduar, se gjatë vizitës kishin qëndruar rreth një orë e gjysmë në

veturë e pastaj me po të njëjtën veturë ishin nisur që të tre për në K. Pastaj faktin se gjykata F. L. e ka gjetur dhe shpallë fajtor me po këtë aktgjykim për shkak se është vërtetuar që i njëjti në vendin e ngjarjes ka shtie me armë zjarri kallashnikov në drejtim të veturës ku ishin F.T. dhe L.T. Prandaj, mbi bazën e të lartcekurave është fare lehtë e kuptueshme se në veprimet e të akuzuarit K.Ç. përmbushen të gjitha elementet e figurës së veprës penale për të cilën edhe është ngritur aktakuza sepse i njëjti një natë më parë ka qenë i përfshirë në rrahjen e cila ka ndodhur në kafiterinë 'Blind' në Kaçanik (fakt ky i vërtetuar me aktakuzën e ngritur ndaj S.L., F.L. dhe K.Ç.); ka qëndruar rreth një orë e gjysmë në veturë së bashku me F.L. dhe A.S. kanë biseduar gjerë e gjatë lidhur me rastin e një dite më parë, me të njëjtën veturë kanë udhëtuar nga fshati S. deri në fshatin R. ku edhe F.L. ka shtie me kallash në drejtim të pandehurit F. dhe L.T., ashtu që duke pas parasysh se është vërtetuar që F.L. ka pas armë zjarri me vete - kallash të cilin edhe e ka përdorë dhe e cila armë ka dimension të gjatë dhe nuk mund të fshihet lehtë, është fare lehtë e kuptueshme se i akuzuari K.Ç. ka qenë në dijeni për përgatitjen e kryerjes së ndonjë veprë penale dhe këtë fakt nuk e ka lajmëruar në kohën kur kryerja e veprës penale ende ka mund të evitohet ndërsa vepra penale është kryer ose është tentuar. Andaj, mbi bazën e të lartcekurave por edhe në rast se gjykata do të vlerësonte drejtë dëshmitë dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës si dhe të merrte parasysh karakteristikat personale të të akuzuarve meqë nga të dhënat rezulton se të njëjtit edhe më parë kanë qenë të përfshirë në kryerjen e veprave tjera penale, ndërsa të akuzuarit F.L. dhe F.T. kanë qenë të gjykuar dhe dënuar edhe më parë, do të vërtetonte drejtë gjendjen faktike, ashtu siç është përshkruar edhe në dispozitivët e aktakuzës, dhe në fund do të bindej që në veprimet e të akuzuarve përmbushen të gjitha elementet e figurave të veprave penale për të cilat edhe është ngritur aktakuza dhe se të njëjtit veprat penale i kanë kryer me dashje direkte. Nga të lartcekurat, ka propozuar si më lartë.

*Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit F.L. av. F.Sh.*

Në ankesë mbrojtësi pretendon se me aktgjykimin e ankimuar nga gjykata shkallës së parë me asnjë provë të vetme nuk ka vërtetuar se i akuzuari F.L. ka kryer vepër penale të vrasjes në tentativë. Nëse i referohemi provave pa i përfshirë deklaratat e të akuzuarit F., A.S. apo edhe K.Ç., prokurori e cilëson të dëmtuar, L.T., e vete ky dëshmitar përshkruan që "nga vetura ka dalur F.L., me një pushkë automatike në dorë dhe ka hipur mbi haubë dhe ka dalur në anën e pasagjerit dhe e ka goditur dritarën me pjesën e pasme të pushkës automatike", e këto deklarime i njëjti i bën gjatë rikonstruimit të vendit të ngjarjes, ku përshkruan se F.L. në momentin kur është shtënë me armë ka qenë në anën e kundërt të veturës, pra nga pjesa e pasagjerit dhe po ashtu pohon se gjuajtja është bërë nga ana e kundërt (dhe ato gjuajtje janë të vetmet që janë bërë

nga vetura ku ka qene edhe F.L., qe F.L. në atë moment siç e pershkruan ky dëshmitar, ka qenë në anën e kundërt nga janë bërë gjuajtjet.

Po ashtu kete version e deklarom edhe i akuzuari F.T. i cili gjatë deklarimit të tij gjatë kqyrjes se vendit të ngjarjes me Prokurorinë, në pyetjet se a ka shkrepur F.L. e që është në vid. M2U00019 nga min 06:40 deri ne 07:10, përshkruan se “F.L. nuk ka shkrepur me armë dhe ka qene e pamundur me shkrepë ai duke qene se në kohën kur është shtëne me armë ka qene në anën e kundërt të veturës nga ku është shtënë”. Se edhe vete palët qe presupozohen nga prokuroria si të dëmtuara, e kanë mohur që nga fillimi dhe në vazhdimesi që F.L. të këtë shtënë e për me teper e kane përshkruar se në momentin kur ka ndodhur shkrepja ka qene në një pozicion të kundërt nga ana ku ka ndodhur shkrepja.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, se të gjitha palët në procedurë duke përfshirë këtu edhe të akuzuarin F.T., edhe dëshmitarin L.T., por edhe të gjithë të tjerët që janë dëgjuar në çfarëdo cilësie në shqyrtim, nuk kanë përmendur që F.L. të këtë shtënë me armë në ditën kritike dhe i vetmi pretendim ka qenë nga F.T. dhe L.T. që pretendojnë se e kanë parë të akuzuarin F.L. të këtë dalë nga vetura me një pushkë të tipit Kallash siç e përshkruajnë ata, por që të dy edhe F. edhe L. thonë se nuk kanë parë të këtë shtënë F.L. për më tepër F.T. në deklaratën e dhënë në rikonstruim të vendit të ngjarjes, thekson se F.L. është e vërtetë të këtë pasur armë në dorë por se i njëjti nuk ka qëlluar.

Më tutje në ankesë mbrojtja ka cituar pjesë të deklarimeve të palëve të dëgjuara në këtë çështje penale, përfshirë këtu të akuzuarit F.T., A.S. dëshmitarin L.T., me konstatim se nga të gjitha këto deklarata për asnjë moment të vetëm në asnjë pjesë të tyre nuk është përshkruar që i akuzuari F.L. të këtë qenë në pozicionin nga ku është shtënë, dhe as të këtë shtënë më armë.

Nga i gjithë përshkrimi por edhe nga rikonstruimi i vendit të ngjarjes është argumentuar pa mëdyshje se derisa kanë qenë duke lëvizur me veturën e A.S., K.Ç. dhe F.L. me të arritur në lagjën "Malzezë", janë hasur në pritë të një veture të tipit Nissan Micra dhe me t'u afruar në një distancë të afërt, kanë parë tani të akuzuarin F.T. u i cili u kishte zënë pritën dhe në pamundësi për të lëvizur, A.S., F.L. dhe K.Ç. kanë ikur në drejtime të ndryshme, respektivisht F.L. ka ikur në pjesën e një rruge mbrapa veturës Nissan Micra që nga pozicioni që kanë qenë i bije rruga në të djathtë, e që ky fakt nuk është kontestues për asnjë palë përveçse F.T. dhe L.T. deklarojnë se fillimisht kanë kaluar në pjesën e veturës nga ana e pasagjerit tek vetura e F.T. ku pretendojnë se e ka thyer xhamin e kësaj veturë dhe ka ikur në rrugën e përshkruar më lartë, dhe në atë moment pretendohet që të jetë shtënë nga ana e kundërt ku ka qenë F.L., e që pasi i akuzuari



F.T. qëllon disa herë në drejtim të A.S. dhe K.Ç., ku si rrjedhojë e godet K.Ç. në pjesën e kurrizit duke e lënë për të vdekur, niset me veturën e tij në drejtimin nga ishte duke ikur F.L. dhe pastaj tenton edhe tri herë me armë që t'a qëllon F.L., e që është fakt i pakontestueshëm për të gjitha palët, madje edhe F.T. edhe L.T. çka ky përshkrim faktik rrëzon teorinë e dispozitivit të aktgjykimit në raport me F.L. dhe në raport me pozicionimin e tij.

Gjykata ka bërë zbatim të gabuar të procedurës penale, rrjedhimisht dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me arsyetimin, duke qenë se asnjë nga faktet e përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit, madje përveç që nuk vërtetohet nuk konstatohet asnjë nga konstatimet e përshkruara në dispozitiv, nuk përmenden askund në arsyetim fjalitë e përdorura sa i përket veprimeve në arsyetimin e këtij aktgjykimi kur bëhet elaborimi i provave. Andaj, gjykata ka bërë aplikim të gabuar të së drejtës materiale kur e ka shpallur fajtor edhe në rigjykim të akuzuarin F.L. për veprat penale, Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 21 par.3 të KPRK-së, dhe veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, duke qenë se nuk është vërtetuar që i akuzuari ka kryer veprat penale që i vihen në barrë. Nga e cekura ka propozuar si më lartë.

#### *Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit A.S. av. L.M.*

Në ankesë mbrojtësi thekson se aktgjykimi i ankimuar është i pa arsyetuar, i pa argumentuar, kundërthënës, se hyrja, dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimit janë kundërthënës dhe si i tillë aktgjykimi është i pa egzaminueshëm. Se A.S. ditën kritike rrugës për t'u kthyer në K. befas vëren një automjet qe ka qenë i parkuar në rrugë në atë drejtim qe ju ka bllokuar lëvizja pasi kishte qenë pritë, me t'u afruar në distancë kanë vërjetur një person jashtë automjeti ku i njëjti person me revole në drejtim të automjetin në të cilin ka qenë A.S. ka shtijë me revole, A. se bashku me bashkëudhëtarët kanë dalë nga automjeti dhe janë munduar t'i shmangën sulmit i cili kishte qenë i atëqasëshëm, i pa paramenduar dhe i pa provokuar, A. ka arritë të ndalet pas automjetit në të cilin kishte qenë, po ashtu A. nuk ka bërë as edhe një veprim të vetëm në dhënjën e ndihmës siç e ngarkon prokuroria e pastaj gjykata. A.S. i është mvëshur tërë përgjegjësia se kinse ka dhënë ndihmë edhe pse nuk është kryes i kësaj vepre penale fare, po ashtu rrethanat që po thirren vazhdimisht në tërë procedurën se i akuzuari ka kryer këtë vepër penale janë jo reale. Gjatë tërë fazës se procedurës është paragjykuar rasti edhe pse provat flasin të kundërtën që përgjegjësia sa i perket A. nuk ekziston, dhe atë as një fakt i vetëm apo indicje që ja vënë në barrë këtë vepër penale. Në këtë çështje penale kemi të bëjmë më vërtetim terësisht të gabuar të gjendjës faktike ngase gjykata shkallës së parë thirret se kinse ka kryer A. veprën penale ndihmë në kryerjen ee veprës penale, ku gjykata shqipton dënim jo meritor në vend që ti nxjerrë

aktgjykim lirues. Se vendimi mbi dënimin si i tillë është i pa qëndrueshëm dhe nuk mund prodhojë efekte juridike, dënimi është shumë i rëndë dhe jo meritore. Në rastin konkret ka qenë e rrezikuar jeta A. andaj edhe vlenë të cekët se është person i cili kontribon për familje, rrethë dhe shoqëri, nuk është kryes i veprës penale, mirëpo përkundrazi i njëjti ka qenë i rrezikuar për jetë nga sulmi i atqasëshëm dhe i pa paramenduar që ju ka bërë automjetit në të cilin ka qenë A. perkatësisht A. nuk ka bërë asnjë veprim të vetëm që bie ndesh me ligjin. Dihet se përgjegjësia penale është subjektive është fajtorë apo nuk është, që në këtë rast është jashtë çdo standardi minimal për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të garantuara edhe me kushtetutë dhe ligj personave të akuzuar në procedurë kur çdo e drejtë i është mohuar vetëm e vetëm të shpallet fajtorë dhe dënohet me një dënim jo meritore me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

*Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit F. T. av. A.I.*

Në ankesë mbrojtësi ka thekësuar se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar. 1.12, lidhur me neni 370 par.6 dhe par.7 të KPPK-së. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përkitazi me faktet vendimtare të prezantuara në dispozitiv, përmban kundërtënie, paqartësi, në arsyetim nuk jepen arsyet përkitazi me faktet vendimtare perkatësisht arsye të cilat prezantohen janë të paqarta dhe në kontradikcion midis vete.

Më tutje, në ankesë prezantohet përmbajtja e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar ku i referohet të akuzuarit F.T., pastaj, dispozitivit ku i referohet të akuzuarit F.L. dhe të akuzuarit A.S. ku, më pastaj, nga përmbajtja e dispozitivit në fjalë mbrojtja konstaton faktet dhe rrëthanat që sipas mbrojtjes janë të përshkruara në kundërshtim të drejtë për drejtë njëra me tjetrën, e që dispozitivi si i tillë rezulton të jetë konfuz dhe i pa qartë, e më pastaj, po ashtu, përmbajtjen e dispozitivave në fjalë e krahason edhe me deklaratat e dëshmitarëve, pastaj, ato të akuzuarve, por, edhe me provat materiale në shkresa të lëndës, duke pretenduar se ka kontradikta edhe në mes provave të proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor. Se arsyet për faktet vendimtare janë në kundërshtim të plotë njëra me tjetrën e që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nënpar. 1.12, e lidhur me nenin 370 par.6 dhe par. 7 të KPPK-së. Se është e paqartë dhe e pakuptueshme në dispozitiv të aktgjykimit se kur, si, dhe pse i akuzuari F. del nga vetura dhe fillon të shtie në drejtim të dëmtuarit K.Ç., perderisa i dëmtuari ka qenë duke ikur në këmbë. Duke qenë se i akuzuari F. nuk e njeh dhe as që e ka njohur ndonjëherë personin K.Ç. personin tani të akuzuarin A.S. si dhe me të akuzuarin F.L. nuk ka pasur ndonjë mosmarrveshje më përpara.

Më tutje mbrojtësi thekëson se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar, nën pikën III, pika a). që i referohet F.T., është në kontradiktë edhe me provat - deklarata e dëshmitarëve L.T. dhe S. Rr.-zyrtarit policor krim-teknikut në Drejtorinë Rajonale në Ferizaj, si dhe provave materiale raporti i shiqimit të vendit të ngjarjës, skicës së vendit të ngjarjës, raportit mbi rikonstruimin, raportit specialistik në emër të K.Ç. si dhe raporti ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me nr.AKF/2021-2014-2021-1894 të datës 07.09.2021, nga të cilat dëshmi përjashtohet mundësia që pjesa metalike që është hequr nga trupi i të dëmtuarit K.Ç. ka rezultuar nga e shtëna në drejtim të trupit të tij, duke qenë se është konstatuar se ajo pjesë metalike e predhës e cila ka qenë e dëmtuar, ka qenë rikoshe.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjës faktike mbrojtësi në ankesë ka thekësuar se më aktgjykimin e ankimuar gjendja faktike gabimisht është vërtetuar, duke qenë se provat e administruar nuk vërtetojnë se i akuzuari F.T. ka ndërmarrë veprimet që me dashje t'a privon nga jeta të dëmtuarin K.Ç. Provat e administruar në shqyrtimin gjyqësor, si ato personale dhe ato materiale vërtetojnë faktet se i akuzuari F.T. dhe i dëmtuari L.T. në ngjarjen kritike kanë qenë të sulmuar nga ana e të akuzuarve F.L., A.S. dhe K.Ç., të cilët sipas marrëveshjes paraprake, të pajisur me armë dhe me mjete të tjera, befas dhe papritmas e kanë sulmuar të dëmtuarin - të akuzuarin F.T. dhe bashkëudhëtarin e tij tani të dëmtuarin L.T., në atë mënyrë që deri sa ishin me veturë të ndalur "Nissan Micra", për t'u kyqyr në rrugë, i kanë bllokuar rrugën me veturën "Golf IV", të pajisur F.L. me armë - pushkë automatike AK-47, A.S. me pushkë të gjuetisë dhe K.Ç. me mjet metalik - gyp i metalt 0.5 inç, i kanë sulmuar, me ç'rast lëndime të rënda trupore ka pësuar i akuzuari F.T. ndërsa lëndime të lehta trupore ka pësuar L.T.

Po ashtu, nga provat materiale vërtetohet fakti që sulmi ishte real, ishte i atëçastshëm dhe ishte i kundërligjshëm, dhe i cili ishte në vazhdim, e që i akuzuari F.T. për të zbrapsur sulmin me revolen e tij që e posedonte deri sa ishte në veturën e tij, me dorën e majt nga dritarja që ishte pjesërisht e hapur, ka shtënë 3 here përpjetë-lart në ajër për të zbrapsur sulmin, e pastaj e ka hapur derën e veturës ka dal jashtë dhe ka shkrep përpjetë - lart në ajër edhe 2 herë, për të zbrapsur sulmin nga ana e të akuzuarve.

Mbrojtja konsideron, se të gjitha provat të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor si ato personale ashtu edhe ato materiale në mënyrë të sigurtë vërtetojnë mbrojtjen e të akuzuarit F.T., se në ngjarjen kritike që është objekt i këtij shqyrtimi ka qenë i sulmuar nga ana e të akuzuarve F.L., A.S.dhe K.Ç.

Më tutje në ankesë mbrojtësi ka cituar pjesë nga deklarimi i të akuzuarit F.T. dhe atë se i njëjti ka shtënë nga revolja 3-4 herë nga brendia e veturës përmes dritarës së hapur, kur ka dal nga vetura ka shtënë përpjetë edhe 3 herë tjera, ndërsa poashtu në momentin kur e kishte parë F. në rrugë me kallash në dorë duke menduar se i njëjti po gjuan në drejtim të tij, atëhere ka shtënë me revole përpjetë 3 herë.

Të gjitha provat, si ato personale ashtu edhe ato materiale të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, vërtetojnë faktin se në asnjë variant nuk ekziston asnjë indikacion e asesi provë se në veprimet të cilat i ka ndërmarrë i akuzuari F.T. kanë qenë të drejtuara në dashje që të dëmtojë trupin e ndonjë prej pjesëmarrësve në ngjarjen kritike. Edhe deklaratat të cilat i kanë dhënë në polici dhe në shqyrtim gjyqësorë F.L., A.S. dhe K.Ç., vërtetojnë faktin se me të akuzuarin F. asnjëherë nuk kanë pasur anjë mosmarrveshje personale, se distanca midis të akuzuarit F.T. dhe personave të përfshirë në ngjarjen kritike ka qenë 4-5 metra, rrethanë kjo që tregon se sikur të kishte ekzistuar dashja siç pretendohet, i akuzuari F. me një lehtësi kishte mundur t'i qëllojë me ato të shtëna të cilat i ka shkrepur secilin prej pjesëmarrësve të ngjarjes kritike.

Nga provat materiale si dhe konstatimet dhe mendimet e ekspertizave balistike si dhe mjekoligjore, është vërtetuar se lëndimi të cilin e pësoj K.Ç. është nga rikosheja e predhës, gjurmët e së cilës hetuesit i kanë konstatuar në skicën e vendit të ngjarjes të evidentuar si D#9 — një këmishëz e predhes së plumbit e mbledhur në rrugë afër vendit të ngjarjes në fshatin Rekë-Kaçanik, e cila në vendin e ngjarjes është gjetur nga pika fikse 2 në distancë prej 84.13 metra, ndërsa në distancë më të afërta D-8 - vendi ku është gjetur jeleku i të dëmtuarit K.Ç. është 18.51 metra.

Nga provat material të administruara në shqyrtim gjyqësor është vërtetuar se i dëmtuari K.Ç. lëndimin e ka pësuar nga rikosheja e cila ka ndodhur në ngjarjen kritike, e që përjashton dashjën në shkakëtimin e lëndimit të cilin e ka pësuar. Pra, mbrojtja vlerëson dhe konstaton se në ngjarjen kritike jo vetëm se nuk ekzistojnë tiparet e figurës së veprës penale vrasje në tentativ, por nuk ekziston asnjë vepër penale e kryer me dashje. Se veprimet e shkrepjes së armës të cilat i ka ndërmarrë i akuzuari F. duke shtënë përpjetë kanë qenë në funksion të zbrapsjes së sulmit të kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm, e që në situatën konkrete ka qenë e vetmja mundësi e domosdoshme për të ndërprerë sulmin e filluar nga të akuzuarit F.L., A.S dhe K.Ç., ndaj tij dhe ndaj të dëmtuarit L.T.

Më tutje në ankesë mbrojtësi ka cituar edhe pjesë të deklarimit të dëshmitarit L.T., S. Rr., E. Q., duke konstatuar se nga keto deklarata vërtetohen rrethanat e prezantuara në mbrojtjen e të akuzuarit F.T. të cilat dëshmi të dëshmitarëve kanë mbështetje edhe në provat materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor.

Mbrojtësi në ankesë ka cituar edhe provat materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor me konstatim se në momentin kur i akuzuari F.T. përdori revolen duke shtënë deri sa ishte në veturën e tij në mënyrën siç e ka përshkruar në deklaratën e tij dhe pastaj me rastin kur doli nga vetura, fakt ky që tregon dhe konfirmon se të shtënat nga revolja nuk i ka drejtuar në drejtim të tani të akuzuarve, por përpjet dhe në ajër me të vetmin qëllim për të ndërprerë dhe evituar sulmin nga të akuzuarit tjerë.

Lidhur me shkeljen e Ligjit Penal mbrojtësi në ankesë ka thekësuar se gjykata e shkallës së parë duke bazuar aktgjykimin e saj në vërtetimin e gabuar të gjendjës faktike, ka shkel ligjin penal në dëm të akuzuarit F.T., kur e ka shpall fajtor për veprën penale vrasje në tentativë nga neni 172, lidhur me nenin 28 të KPRK-së, edhe pse në veprimet e të akuzuarit nuk ekziston dashja dhe veprimi i kryerjes si tiparet qënsore të figures së veprës penale të lartë cekur.

Lidhur me vendimin mbi dënimin mbrojtësi në ankesë ka thekësuar se dënimi i shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 2 vite e 6 muaj, dhe dënimi me gjobë në shumë prej 1000 euro, është i ashpër dhe nuk qëndron në proporcion me rrethanat që i referohen ngjarjes kritike dhe rrethanat subjektive që i përkasin personalitetit të akuzuarit. Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata drejtë konstatoi se rrethanat në kuptim të neni 69 dhe 70 të KPRK-së, në veçanti dhe në tërsi janë të natyrës lehtësuese e disa edhe veçanërisht lehtësuese. Rrethanat e cekura lehtësuese disa veçënisht lehtësuese, tregojnë se shkalla e pergjegjësisë penale e të akuzuarit është e lehtë dhe e butë, dhe me siguri do të arrihet qëllimi i dënimit, duke qenë se edhe gjykata konstatoi se nuk ekziston asnjë rrethanë rënduese në rastin konkretë. Nga e cekura mbrojtësi ka propozuar si më lartë.

## **Vlerësimi i Gjykatës së Apelit**

### Të gjeturat për pretendimet ankimore për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale

Kolegji Penal i Gjykatës së Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore të mbrojtësve të akuzuarve F.L., A.S. dhe F.T. për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat,

sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo Gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Kolegji gjen se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin dhe përpilimin e dispozitivit.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, janë dhënë arsytet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale-juridike, duke vepruar konform dispozitave të nenit 370 par.6 të KPPK-së, gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur arsytet për çdo pikë të aktgjykimit dhe atë si ato faktike dhe ato juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 361 par.1 të KPPK-së, duke dhënë arsye të qarta dhe konkrete për vendin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprave penale nga të akuzuarit, për të cilat vepra penale të akuzuarit janë shpallur fajtor dhe gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur përfundimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo Gjykatë, prandaj thënie të ankimore se kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale konstatohen të paqëndrueshme.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.L. av. F.Sh. thekson se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për faktin se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit, në mungesë të provave, nuk ka arritur t'a sqaroj në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron si të vërtetuara, kjo për faktin se gjatë arsyetimit të aktgjykimit gjykata faktet që konstaton se i ka vërtetuar janë në kundërshtim me vetveten dhe se gjykata nuk arsyeton në mënyrë bindëse dhe të drejtë faktin, se cilat ishin provat vendimtare kur të akuzuarin F.L. e shpalli fajtor për veprën penale të cekur më lartë.

Kolegji vlerëson të pabazuar thënie të ankimore të lartcituara, se mungojnë arsytimet bindëse dhe se nuk dihet cilat ishin provat vendimtare, dhe gjënë se në aktgjykimin e ankimuar janë dhënë arsye dhe shpjegime të mjaftueshme për vlerësimin si të provave materiale, ashtu edhe dëshmime për secilen veç e veç ashtu edhe në tërësinë e tyre. Pasi që nga dëshmia e dëshmitarit L.T. mbrojtja e të akuzuarit F.T. dhe nga provat tjera të administruara në shqyrtim gjyqësor nga

gjykata shkallës së parë është vërtetuar se i akuzuari F.L. me dashje ka tentuar që t'i privoj nga jeta të dëmtuarit F. dhe L.T..

Kolegji gjen të pabazuara theksimet në ankesë të mbrojtësi i të akuzuarit A.S. av. L.M., pasi që dispozitivi është i qartë dhe janë dhënë arsyet mbi faktet vendimtare dhe është bërë vlerësimi i mjaftueshëm i provave dhe se nuk kemi të bëjmë me aktgjykim të pa arsyetuar, të pa argumentuar, kundërthënës.

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit F.T., av. AI. thekson se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar. 1.12, lidhur me neni 370 par.6 dhe par.7 të KPPK-së, se aktgjykimi i ankimuar përkitazi me faktet vendimtare të prezantuara në dispozitiv, përmban kundërthënie, paqartësi, në arsyetim nuk jepen arsyet përkitazi me faktet vendimtare përkatësisht arsye të cilat prezantohen janë të paqarta dhe në kontradiksion midis vete.

Kolegji gjen se në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar janë përshkruar veprimet e të akuzuarit F.T. dhe në arsyetim janë dhënë shpjegimet e duhura mbi veprimet e ndërmarrura nga i akuzuari në kryerjen e veprave penale për të cilat është shpall fajtor, dhe se mbi gjendjen e fakteve të provuara ka derivuar edhe përgjegjësia penale e këtij të akuzuari. Në aktgjykim janë paraqitë në mënyrë të plotë dhe të qartë faktet të cilat kanë vërtetuar kryerjen e veprave penale nga i akuzuari F.T. për të cilat është shpallur fajtor. Në aktgjykim janë paraqitë qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye gjykata i konsideron të vërtetuara, si dhe janë vlerësuar provat në mënyrë të plotë.

#### Të gjeturat lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji penal i Gjykatës së Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se të akuzuarit F.L., A.S. dhe F.T. kanë kryer veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor.

Deri të vërtetimi i gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë ka ardhur pas administrimit të provave dhe atë: Fotografit që janë në shkresat e lëndës, Fletë lëshimi me numër të amzës 1447,

i datës 08.03.2021, lëshuar nga QKUK- Klinika e Kirurgjisë Torakale në Prishtinë në emër të K. Ç. Raporti mjekësorë në emër të L.T. me numër 526, i datës 25.03.2021, lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj, Raporti mjekësorë në emër të F.T., me numër 1020, i datës 31.03.2021, lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm Ferizaj, Akt ekspertimi mjeko ligjor në bazë të dokumentacionit të çështjes me numër reference FE-15, i datës 05.04.2021, Plotësimi i mendimit i datës 13.07.2021, nga eksperti mjeko ligjor Dr. N.U. Raporti plotësues i kallëzimit penal pas zbatimit të urdhërësës për kontroll, të datës 18.05.2021, Tre procesverbale mbi kontrollimin e banesave, lokaleve dhe personave të datës 18.05.2021, Dy vërtetime mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 18.05.2021, Mendimi i grupit të ekspertëve lidhur me natyrën e lëndimeve trupore dhe pasojat për F.T. dhe L.T. të datës 05.06.2021, së bashku me CD-në e bashkangjitur, Raporti i rikonstruimit të vendit të ngjarjes, së bashku me fotoalbumin dhe CD-në, të datës 08.07.2021, Raporti i ekspertimit nga Agjencia Kosovare e Forenzikës me numër AKF/2021-1383/2021-1280 i datës 29.06.2021, Raporti specialistik në emër të K.Ç., me numër 515, i datës 08.07.2021, Raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me numër AKF/2021-2014/2021-1894 të datës 07.09.2021, leximi I procesverbalit për rikonstruim të vendit të ngjarjes të datës 11.10.2023 (nga një CD e vendit të ngjarjes gjykata u'a ka dorëzuar me kohë palëve), leximi i deklaratave të dëshmitarëve: L.T., S.Rr. F.C. dhe E.Q. të dhëna gjatë seancave të shqyrtimit të parë gjyqësorë, pasi që për këtë kishje pajtim unanimit nga të gjitha palët.

Duke u bazuar në këto prova të cilat janë administruar, vlerësuar dhe analizuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, kolegji gjen se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, dhe se është vërtetuar se të akuzuarit e lartë cekur kanë kryer veprat penale si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Të pabazuara kolegji gjen pretendimin e mbrojtësit të akuzuarit F.L. av. F.Sh. se me aktgjykimin e ankimuar me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar se i akuzuari F.L. ka kryer vepër penale të vrasjes në tentativë, se vetë palët që presupozohen nga prokuroria si të dëmtuara, e kanë mohur që nga fillimi dhe në vazhdimësi që F.L. të këtë shtënë me armë e për me tepër e kanë përshkruar se në momentin kur ka ndodhur shkrepija i njëjti ka qenë në një pozicion të kundërt nga ana ku ka ndodhur shkrepija.

Kolegji pajtohet me gjetjet e gjykatës së shkallës së parë se sa i përket ngjarjes së datës 7 mars 2021, pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe shkaqeve të përshkruar me detajsh në aktgjykimin e ankimuar ka shpie deri të ngjarja e përshkruar në aktgjykimin e ankimuar. Po ashtu, është



vërtetuar se bëhet fjalë për një rivalitet të mëhershëm në mes F. e L.T. në një njërën anë dhe F. e S.L. (ky i fundit i pa përfshirë në ngjarje) dhe K.Ç. në anën tjetër, e që si rrjedhojë e këtij rivaliteti, ishte zhvilluar ngjarja më 6 mars 2021 në kafiterinë “Blind”, në Kaçanik, dhe si pasojë e asaj ngjarje të akuzuarit: F.L., A.S. dhe K.Ç. me veturën e tyre “Golf IV”, të cilën e ka drejtuar A.S. që njëherit ishte vetura e tij në njërën anë, dhe të akuzuarit F.T. dhe L.T. me veturën e tipit “Nisan Mickra”, të cilën e ka drejtuar F.T., janë takuar në fshatin Rekë, Komuna e K., ku nga vetura tipit “Golf IV”, kanë dalur të akuzuarit F.L., A.S. dhe K.Ç., ndërsa nga vetura “Nisan Mickra”, ka dalur vetëm i akuzuari F. e që është vërtetuar se i akuzuari F.L. ka shtier me pushkë automatike AK 47, në drejtim të veturës “Nisan Mickra”, ku kanë qenë F. e L.T. me ç’rast si pasojë e të shtënave me armë, të akuzuarit-dëmtuarit F.T., i shkaktohen dëmtime të rënda trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, sikundër që i akuzuari F.T. me të dalur nga vetura ka gjuajtur në drejtim të akuzuarve F.L., A.S. dhe K.Ç. me ç’rast si pasojë e të shtënave me armë, të dëmtuarin K. e godet në pjesën e pasme të shpinës, duke i shkaktuar lëndime trupore. Kjo gjendje faktike është vërtetuar nga dëshmitari L.T. dhe kryesisht nga mbrojtja e të akuzuarve, edhe pse të akuzuarit kanë dhënë versione të ndryshme, në ndërlidhje edhe me provat materiale dhe rrjedhimisht edhe përmes rikonstruimit të vendit të ngjarjes.

Kolegji gjen të pabazuara pretendimete e mbrojtësit të akuzuarit F.L. se nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij të ketë shtënë me armë ditën kritike nga se të gjitha palët në procedurë duke përfshirë këtu edhe të akuzuarin F.T., edhe dëshmitarin L.T. por edhe të gjithë të tjerët që janë dëgjuar në çfarëdo cilësie në shqyrtim gjyqësor, nuk kanë përmendur që F.L. të ketë shtënë me armë në ditën kritike dhe i vetmi pretendim ka qenë nga F.T. dhe L.T. që pretendojnë se e kanë parë të akuzuarin F.L. të ketë dalë nga vetura me një pushkë të tipit Kallash siç e përshkruajnë ata, por që të dy edhe F. edhe L. thonë se nuk kanë parë që të ketë shtënë F.L., për më tepër F. T. në deklaratën e dhënë në rikonstruim të vendit të ngjarjes, thekson se F.L. është vërtetë të ketë pasur armë në dorë por se i njëjti nuk ka qëlluar.

Kolegji vëren se i akuzuari F.L. në mbrojtjen e tij ka mohuar kryerjen e veprave penale, dhe me të drejtë gjykata shkallës së parë ka vlerësuar këtë mbrojtje si të pa qendrueshme në tërësi pasi që si e tillë nuk gjen mbështetje në provat tjera dhe atë kryesisht nuk mbështetet në dëshminë e dëshmitarit L.T. dhe mbrojtjen e të akuzuarit F.T., të cilët kanë përshkruar dhe identifikuar të akuzuarin F.L. si personin e vetëm i cili ditën kritike kishte dalur nga vetura “Golf IV”, me armë në dorë - pushkë automatike, të cilën e kanë quajtur “Kallashnikov”, edhe pse të njëjtit po ashtu kanë deklaruar se nuk e kanë parë momentin e gjuajtjes, mirëpo fakti i gjuajtjes është vërtetuar me prova tjera dhe atë: Akt ekspertimi në lidhje me lëndimet trupore të të akuzuarit F.T. i

përpiluar nga ekspertit Dr.N.U. e datës 5 prill 2021, ku është konstatuar se dëmtimet janë si pasojë e armës së zjarrit, të shkaktuar si rezultat i veprimit mekanik të predhës së hedhur nga armë zjarri, Raporti plotësues i ekspertizës nga ana e grupit të ekspertëve prej 3 anëtarëve: Dr. M.H. Dr. F.M. dhe Dr.N.D. të datës 5 qershor 2021, në të cilën ekspertizë mes tjerash është konstatuar se dëmtimet e sipër përshkruara në gjetje-konstatim paraqesin: trupa të huaj metalik në pjesën e kërcirit dhe gjurit të djathtë....vrraja si pasojë e plagëve prerëse-shkyese në pjesën e kërcirit dhe gjurit të djathtë, Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 7 mars 2021, i bërë nga Policia e Kosovës-Njësia e Forenzikës në të cilin raport mes tjerash është konstatuar se gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes kemi vërejtur se kishte pasur shkëmbim zjarri nga dy armë sepse janë gjetur katër (4) copë gëzhoja të kalibrit 9 mm dhe një (1) gëzhojë e kalibrit 7.62 mm e armës së zjarrit AK-47, Raporti plotësues i rikounstrimit të vendit të ngjarjes si pjesë e përmbajtjes së dosjes së forenzikës 2021-CE-88 të datës 14 mars 2021 nga Policia e Kosovës-Drejtoria Rajonale në Ferizaj, në të cilin përveç tjerash është konstatuar se sipas deklarimeve të personave të dyshuar të cilët ishin të involvuar në vendin e ngjarjes, deklaratimet e tyre janë kundërthënëse njëra me tjetrën, dhe nuk përputhen me disa fakte dhe prova të gjetura në vendin e ngjarjes gjegjësisht në veturën e tipit Nisan, siç janë një gëzhojë e armës së zjarrit AK47 dhe një pjesë e karikatorit mbyllës i pjesës së poshtme. Më tej në atë raport në pjesën përfundimtare është konstatuar Vlen të ceket se në vendin e ngjarjes janë përdorur dy armë zjarri pasi që në vendin e ngjarjes kemi gjetur dy lloje të gëzhojave të kalibrit 7.62x39 mm dhe 9x19 mm, Raporti i Ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë AF/2021-1383/2021-1280 i datës 29 qershor 2021, e që i është referuar urdhëresës së Prokurorisë, përmes së cilës përveç terash është kërkuar të konstatohet lloji i armës nga të gjeturat e gëzhojës sipas evidencës D#5, e që sipas konstatimit të Agjencisë, ka rezultuar se dëshmia D#5 është një gëzhojë pjesë e fishekut të kalibrit 7.62x39 mm, është gjuajtur nga një armë e kalibrit të njëjtë 7.62x39 mm, e që sipas të dhënave rezulton se ky lloj i armëve emërtohet si AK-47, Procesverbali mbi kontrollimin e banesës, lokaleve dhe personave, i përpiluar Policia Kosovës, Sektori Rajonal i Hetimeve-Ferizaj, në të cilin është konstatuar Me 18.05.2021 me urdhër të Gjykatës Themelore në Ferizaj UGJK.25/21 është realizuar kontrolli i shtëpisë dhe objekteve tek i dyshuari F.L. në fshatin S-K. Gjatë kontrollit në objektin përcjellës (në odë) janë gjetur dhe sekuestruar 21 copë fishek të armës AK-47.

Andaj, bazuar në provat e theksuara si më lartë e bëjnë të besueshëm faktin se ka qenë pikërisht i akuzuari F.L. i cili ka gjuajtur në drejtim të akuzuarit F.T. dhe të dëmtuarit L.T., duke përjashtuar çdo konkluzion tjetër që do t'a vente në pikëpyetje këtë fakt.

Pretendimi i mbrojtësit se i akuzuari F.L. nuk ka pasur armë ditën kritike, nuk përputhet as me mbrojtjen e të akuzuarit A.S. i cili në fazën e shqyrtimit gjyqësorë ka pranuar se ka pasur armë dhe se i njëjti edhe ka gjuajtur, gjë që më të drejtë gjykata shkallës së parë ka hedhë poshtë teorinë e të akuzuarit F.L. se nuk kanë pasur armë.

Kolegji gjen të pa bazuara pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit F.T. se provat e administruar nga gjykata shkallës së parë nuk vërtetojnë se i akuzuari F.T. ka ndërmarrë veprimet që me dashje ta privon nga jeta të dëmtuarin K.Ç., se nga nga provat materiale vërtetohet fakti që sulmi ishte real, i atëçastshëm dhe i kunderligjshëm, dhe i cili ishte në vazhdim, e që i akuzuari F.T. për të zbrapsur sulmin me revolen e tij që e posedonte deri sa ishte në veturën e tij, me dorën e majt nga dritarja që ishte pjesërisht e hapur, ka shtënë 3 here përpjetë-lart në ajër për të zbrapsur sulmin, e pastaj e ka hapur derën e veturës ka dal jashtë dhe ka shkrep përpjetë - lart në ajër edhe 2 herë, për të zbrapsur sulmin nga ana e të akuzuarve.

Kolegji rikujton se i akuzuari F.T. ka pranuar fajësinë për veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, madje i njëjti ka pohuar faktin se ka gjuajtur edhe pse ka mohuar që ka gjuajtur në drejtim të akuzuarve F.L., A. S. dhe K.Ç. mirëpo edhe mbrojtja e këtij të akuzuar duke e mohuar drejtimin e gjuajtjes me armë nuk përputhet me provat që janë administruar dhe atë nga deklarimi i të akuzuarve F.L. dhe A.S. të cilët kanë deklaruar se me t'u afruar në një distancë 4-5 metra e kanë vërejtur të akuzuarin F. i cili ka dalë nga vetura e tij me armë në dorë dhe e kanë vërejtur se armën e ka pasur të drejtuar në drejtim të tyre. Përveç kësaj ky fakt vërtetohet edhe me prova materiale si: Përmbajtja e dosjes së forenzikës, e cekur më lartë, akt ekspertimi për të dëmtuarin K.Ç. në të cilin është konstatuar se lëndimet e rënda trupore i ka si pasojë e armës së zjarrit, e që këto prova dhe prova tjera e bëjnë të besueshëm dhe të pa kontestueshëm faktin se i akuzuari F.T... me rastin e gjuajtjes së tij me armës zjarri e kalibrit 9x19 mm, e ka goditur të akuzuarin, tani të dëmtuarin K.Ç. në regjionin e shpinës.

Edhe pse mbrojtja pretendon se lëndimi i të dëmtuarit K.Ç. me predhë, është si pasojë e lëvizjes së predhës nga toka, për kolegjin një pretendim i tillë është i paqëndrueshëm, pasi që vetë i akuzuari F. gjatë mbrojtjes së tij ka pohuar faktin se ka gjuajtur me armë më shumë se një herë, që nënkupton se pavarësisht faktit se i akuzuari K. lëndimet trupore i kishte marrë nga predha jo nga gjuajtja në drejtim të tij në mënyrë të drejtpërdrejt, megjithatë është vërtetuar se i akuzuari kishte gjuajtur disa herë. Ndërsa në lidhje me këtë se, sipas theksimeve të mbrojtësit të akuzuarit

se kinse i akuzuari F. ka gjuajtur në dy raste në ajër, për kolegjin një pretendim i tillë është i pa qëndrueshme dhe i pa mbështetur me provat e shqyrtuara.

Kolegji penal mbeshtet gjetjet e gjykatës së shkallës së parë lidhur me mundësinë eventuale të tejkalimit apo mbrojtjes së nevojshme në tërësi të njërit apo tjetrit të akuzuar, mirëpo ashtu siç u theksua edhe më lartë se raportet e dy grupeve ishin të acaruar për një kohë, e që si shkas ishte një ngjarje një ditë më parë në kafiterinë “Blind në Kaçanik”, pastaj mënyrën se si janë takuar, konkretisht dy veturat kanë qenë duke shkuar në të njëjtin drejtim, (ky fakt është vërtetuar gjatë rikonstrumit të vendit të ngjarjes nga ana e gjykatës së shkallës së parë) kanë përjashtuar institutin e mbrojtjes së nevojshme, respektivisht tejkalimin e mbrojtjes së nevojshme, pasi që mes tyre ka ekzistuar dashja për të kryer veprë penale.

Kolegji gjen të pa bazuara pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit A.S. se të mbrojturit të tij i është mveshur në tërë përgjegjësi se kinse ka dhënë ndihmë edhe pse nuk është kryes i veprës penale fare, se provat flasin të kundërtën, se përgjegjësi sa i perket A. nuk ekziston, dhe atë as një fakt i vetëm apo indicje nuk ekziston që ja vënë në barrë veprën penale.

Kolegji pajtohet me gjetjet e gjykatës së shkallës së parë se ndihma e të akuzuarit A.S. ka konsistuar në vënien në dispozicion të mjetit për kryerjen e veprës penale, duke i vënë të akuzuarit F.L. në dispozicion veturën e tij (madje duke e vozitur personalisht) e që kjo ndihmë ka rezultuar të jetë thelbësore në kryerjen e veprës penale nga ana e të akuzuarit F.L. sepse të njëjtit i ka garantuar dhe siguruar transportin që ka shpie deri tek vendi i ngjarjes. Fajësia e këtij të akuzuari është vërtetuar nga mbrojtja e të akuzuarit F.L. dhe nga mbrojtja e vetë të akuzuarit, pasi edhe njëri edhe tjetri kanë deklaruar se i akuzuari pak para ngjarjes që është objekt i kësaj çështje penale, së bashku me të akuzuarin K.Ç. ka shkuar tek shtëpia e të akuzuarit F.L. me të cilin ka qëndruar 1 orë apo 1 orë e gjysmë në veturë, e që pastaj janë nisur në drejtim të K. ku pastaj me të arritur në fshatin R., Komuna e K., është zhvilluar ngjarja siç përshkruhet në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Se sa i akuzuari ka qenë i vendosur për t’u ndihmuar të akuzuarin F.L., tregon edhe fakti se i njëjti me rastin e deklarimit gjatë mbrojtjes së tij ka theksuar se duke u fshehur nga i akuzuari F.T. e hap bagazhin dhe nga aty merr pushkën, siç e ka përshkruan si pushkë të gjuetisë.

Andaj, kolegji penal i Gjykatës se Apelit duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lart, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se në këtë çështje penale nuk ka mbetur pa u vërtetuar asnjë fakt vendimtar.

### Të gjeturat për pretendimet ankimore lidhur me shkeljen e ligjit penal

Kolegji gjen të pabazuar pretendimin e mbrojtësit të akuzuarit F.L. av. F.Sh. se duke qenë se nuk është vërtetuar që i akuzuari ka kryer veprat penale që i vihen në barrë, gjykata shkallës së parë ka bërë shkelje të ligjit penal, kur ka shpallur fajtor të akuzuarin F.L. për veprat penale, Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 21 par.3 të KPRK-së, dhe veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Po ashtu, kolegji gjen të pabazuar pretendimin e mbrojtësit të akuzuarit F.T. av. A.I. se gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në vërtetimin e gabuar të gjendjës faktike, ka shkel ligjin penal në dëm të akuzuarit F.T., kur të njëjtin e ka shpall fajtor për veprën penale, Vrasje në tentativë nga neni 172, lidhur me nenin 28 të KPRK-së, edhe pse në veprimet e të akuzuarit nuk ekziston dashja dhe veprimi i kryerjes si tipare qënsore të figurës së veprës penale.

Kolegji vlerëson se me aktgjykimin e ankimuar nuk është shkelur ligji penal siç pretendojnë mbrojtësit e të akuzuarve në ankesat e tyre. Kjo për faktin se veprimet e të akuzuarit F.L. i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale, Vrasja në tentativë nga neni 172, lidhur me 28 të KPRK-së, dhe të veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, për të cilën është shpallur fajtor, dhe veprimet e të akuzuarit F.T. i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale, Vrasja në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 21 par.3 të KPRK-së, dhe veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, se për këto vepra penale të njëjtit janë penalisht përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të akuzuarve.

### Të gjeturat për vendimin mbi dënimin

Kolegji Penal i Gjykatës së Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të prokurorit për dënim më të ashpër, ndërsa të mbrojtësve të akuzuarve, për një dënim me të butë, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese për tre të akuzuarit gjykata mori parasysh moshën relativisht të re të tyre, ndërsa në mënyrë të veçantë si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin F.T., gjykata mori parasysh faktin se i njëjti në mbrojtjen e

tij duke filluar nga marrja në pyetje në stacionin policor e deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësorë, ka qenë konsistent, ku përveç mohimit të veprimeve inkriminuese, rrethanat tjera i ka pasqyruar në mënyrë të saktë, madje edhe pas paralajmërimit nga kryetari i trupit gjykues se mund të inkriminohet për ndonjë veprë penale, i njëjti ka treguar për rivalitetin e tij me vëllaun e të akuzuarit F.L., i quajtur S.L. Po ashtu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin F., nga gjykata është konsideruar pranimi i fajësisë për veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së. Gjithashtu gjykata për gjithë të akuzuarit si rrethanë lehtësuese ka marrë për bazë sjelljet e tyre pas kryerje së veprave penale, e që në këtë drejtim të akuzuarit edhe pse kishin pasur mosmarrëveshje të mëhershme, pas ngjarjes për të cilën janë shpallur fajtor nuk ishte raportuar për asnjë mosmarrëveshje në mes tyre. Për më tepër i akuzuari F.T. në seancën e shqyrtimit gjyqësorë të datës 04.12.2023 ka deklaruar se pavarësisht se kishin mosmarrëveshje më herët me të akuzuarit tjerë, ka ndodhur që të shihen mes vete dhe se tani nuk kanë ndonjë mosmarrëveshje mes tyre. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata për të akuzuarit ka vlerësuar se të njëjtit, bazuar në të dhënat e siguruara përmes sistemit SMIL, rezulton se bëhet fjalë për persona që edhe më parë kanë qenë të gjykuar për vepra të ndryshme penale, e që po ashtu në lidhje me këtë aspekt i akuzuari F. T. ka qenë më shumë i gjykuar dhe dënuar me aktgjykime të formës së prerë, në raport me të akuzuarit tjetër. Andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykata të akuzuarve: F.L., A.S. dhe F.T., u ka shqiptuar dënim burgimi të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, me bindjen se me dënimet e shqiptuara është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmën si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale.

Një vlerësim të tillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo Gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara rënduese në ankesën e prokurorit si shkallën e përgjegjësisë së tyre penale, shkallën e lartë të dashjes për kryerjen e veprave penale, motivin e kryerjes së veprave penale, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, jetës së njeriut janë pretendime të përgjithësuara, të cilat nuk e justifikojnë shqiptimin e një dënimi me të ashpër, kurse disa nga rrethanat në të cilat thirren mbrojtësit e të akuzuarve dhe atë se shkalla e rrezikeshmerisë ka qenë e lehtë dhe e butë, gjendjen ekonomike dhe familjare, sjelljet e mira në rrethë dhe shoqëri ku të akuzuarit jetojnë, kanë qenë objekt vlerësimi nga gjykata e shkallës së parë, kurse të tjerat edhe

pse nuk kanë qenë objekt vlerësimi nuk janë të asaj natyre që justifikojnë zbutjen e dënimit kur merret parasysh pesha e veprave penale, andaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj Gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave të kryera penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve si ekzekutor, dhe me intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me të do të mund të parandalohen të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmën, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Kolegji gjen të pa bazuara pretendimet e Prokurorit se gjykata shkallës së parë të akuzuarin K.Ç. gabimisht e ka liruar nga akuza, ngase në veprimet e këtij të akuzuari janë përmbushur të gjitha elementet e figurës së veprës penale për të cilën edhe është ngritur aktakuza sepse i njëjti një natë më parë ka qenë i përfshirë në rrahjen e cila ka ndodhur në kafiterinë “Blind”, në K. se i akuzuari K.Ç. ka qenë në dijeni për përgatitjen e kryerjes së ndonjë veprë penale dhe këtë fakt nuk e ka lajmëruar në kohën kur kryerja e veprës penale ende ka mund të evitohet ndërsa vepra penale është kryer ose është tentuar që të kryhet.

Kolegji pajtohet me gjetjet e gjykatës së shkallës së parë se pas administrimit të gjitha provave në shqyrtim gjyqësor nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari K.Ç. ka kryer veprën penale, Moslajmërimi i përgaditjes së veprave penale nga neni 377 par.1 të KPRK-së, madje kjo nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme. Pavarësisht faktit se është vërtetuar se i akuzuari K.Ç. së bashku me të akuzuarin A.S. ishin më 7 mars 2022 në shtëpinë e të akuzuarit F.L. në fshatin S. komuna e K. ku kishin qëndruar rreth një orë e gjysmë dhe si rrjedhojë me t’u kthyer në drejtim të Kaçanikut, po ashtu ka qenë i pranishëm edhe në vendin e ngjarjes, madje edhe është qëlluar me armë zjarri nga ana e të akuzuarit F.T. kjo nuk e bënë të besueshëm faktin se i akuzuari ka pasur dijeni për përgaditjen e kryerjes së veprës penale të vrasjes, andaj pretendimi i prokurorisë se i akuzuari ka qenë në dijeni ka mbetur në suaza të dyshimit. Pra, nuk është vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se i akuzuari K.Ç. ka qenë në dijeni se do të kryhet vepra penale për të cilën janë shpallur fajtor të akuzuarit e lartë cekur. Ndërsa fakti se i akuzuari A.S. është shpallur fajtor për veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasja e mbetur në tentativë, kolegji vëren se në raport me të akuzuarin A.S. kishte edhe prova tjera

përveç faktit se tre të akuzuarit kishin qëndruar së bashku rreth një orë e gjysëm në veturë, se është vërtetuar se i akuzuari A.S. i kishte dhënë në dispozicion veturën të akuzuarit F.L., me të cilën veturë të akuzuarit edhe kishin arritur në vendin e ngjarjes, ku edhe ishin kryer veprat penale siç përshkruhen në dispozitiv të aktgjyqimit të ankimuar. Andaj, kolegji vleron se gjykata shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka liruar nga akuza të akuzuarin K.Ç., konform nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së, pasi që nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Nga arsyet e sipër cekura dhe në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda**  
**PAKR.nr.121/2024, datë 12.04.2024**

**B. Profesional**

**Anëtarët e kolegjit**

**Kryetari i kolegjit**

\_\_\_\_\_  
**Bajram Rexhahmetaj**

\_\_\_\_\_  
**Afërdita Bytyçi**

\_\_\_\_\_  
**Xhevdet Abazi**

\_\_\_\_\_  
**Zyhdi Haziri**